

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË

WINDSENSE SH.P.K.

Sot, më 15. 08. 2022, ortakët (më poshtë referuar si “Ortakët Themelues”, ose “Ortakët”), si më poshtë vijon:

- (i) **AES Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NUIS L91910013P, dhe me adresë në Rr. "Myslym Shyri" Pallati 49, shk.1, kati 2, Tiranë; dhe
- (ii) **Klea Sunpower Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NUIS M21912055R, dhe me adresë në Rrugën “Ruga e Elbasanit”, Pallati Edil Al-It (American 2), Kati 2, Zyra 216, Tiranë.

vendosën mbi këtë Akt Themelimi për krijimin dhe themelimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar Windsense.

I. Themelimi

Ortakët Themelues deklarojnë themelimin e shoqërisë Windsense Sh.p.k., një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”), e cila themelohet në përputhje me ligjin e aplikueshëm tregtar në Republikën e Shqipërisë.

Selia e Shoqërisë është në adresen: Ruga e Elbasanit, Pallati Edil Al-It (American 2), Kati 2, Zyra 216, Tirane, Shqiperi.

Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pakufizuar.

II. Selia e regjistruar e Shoqërisë

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në adresën: Ruga e Elbasanit, Pallati Edil Al-It (American 2), Kati 2, Zyra 216, Tirane, Shqiperi.

III. Objekti

Objekti i Shoqërisë, do të perfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje, direkt apo indirekt, në shoqëri tregtare, entitete juridike të tjera, qofshin këto në Shqipëri apo juridiksione të tjera, dhe investime në kapitalin e tyre;
- të gjitha dhe çdo aktivitet të lejuar, perfshire shitblerjen e te gjitha sherbimeve dhe ose mallrave, ne perputhje me legjisacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë dhe veçanërisht zhvillimin, projektimin, ndërtimin e impianteve të



1
Ez

energjisë elektrike, si dhe prodhimin, dhe tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike, me fokus te vecantë në burimet e rinovueshme ;

- aktivitete import, eksport të të gjitha mallrave dhe shërbimeve.

Shoqëria do të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj të aktivitetit dhe/ose që lidhet me objektin e saj.

Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse në Republikën e Shqipërisë dhe standarde më të mira et ke.

IV. Statuti

Ort kët Themelues deklarojnë miratimin dhe zbatimin e Statutit të Shoqërisë. Aktiviteti dhe veprimtaria e Shoqërisë do të kryhen në përputhje me Statutin e së Shoqërisë dhe rregullat e detyrueshme të legjislacionit shqiptar.

V. Kapitali

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është ALL 100.00 (njëqind lekë), i ndarë ne 2 (dy) kuota të barabarta mes dy Ortakëve Themelues të Shoqërisë, dhe ai zoterohet nga ortakët e Shoqërisë, si më poshtë vijon:

- (i) **AES Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me NUIS L91910013P, cila zoteron 1 (një) kuotë, në vlerën 50 lekë, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- (ii) **Klea Sunpower Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me NUIS M21912055R, cila zoteron 1 (një) kuotë, në vlerën 50 lekë, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

Çështje të tilla si zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë, si dhe Administrimi Financiar dhe Kontabël i Shoqërisë detajohen në Statutin e Shoqërisë, i cili firmoset dhe ekzekutohet në mënyrë të rregullt nga Ortakët Themelues të Shoqërisë, së bashku me këtë Akt Themelimi.

VI. Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërise janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë; dhe
- 2) Administratori i Shoqërisë.



Handwritten signatures of the shareholders, including the signature of AES Group Sh.p.k. and Klea Sunpower Sh.p.k., along with their respective initials and the number 2 indicating they represent 50% of the capital.

VII. Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, është organi më i lartë vendimmarres dhe i kontrollit të Shoqërisë e cila merr vendime në lidhje me aktivitetin e saj dhe politikat ekonomike dhe tregtare të saj.

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë të detajuara në mënyrë të hollësishme në Statutin e Shoqërisë, i cili firmoset dhe ekzekutohet nga Ortakët Themelues të Shoqërisë.

VIII. Administratori

Shoqëria përfaqësohet dhe menaxhohet nga 1 (një) Administrator, i propozuar nga ortaku AES Group Sh.p.k., i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për aktivitetin e zakonshëm të tregtar të Shoqërisë me përjashtim të atyre çështjeve që parashikohen në këtë Statut dhe nga ligji i zbatueshëm apo vendimeve të Ortakëve.

Administratori i parë i Shoqërisë është:

Z. Besmir KOKOMIRI, shtetas shqiptar, lindur më [02.11.1987] në [Tirane, Shqiperi], banues në [Rr. Elbasanit, Pallati 2-G, Apartamenti nr.15; mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I71102031N] ("Administrator").

Administratorët emërohen për një afat në detyrë prej 3 (tri) vitesh nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri ("QKB") me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë. Me miratimin e emërimit të tij/saj, Administratori njeh se marrëdhënia e tij/saj me Shoqerinë është një marrëdhënie strikte besimi. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërise ka kompetencë që të shkarkojë Administratorin nga detyra e tij/saj në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkaku.

Të gjitha kompetencat, detyrimet, të drejtat dhe kufizimet e Administratorit të Shoqërisë, si dhe mënyra e përzgjedhjes dhe emërimit, janë të detajuara në mënyrë të hollësishme në Statutin e Shoqërisë, i cili firmoset dhe ekzekutohet nga Ortakët Themelues të Shoqërisë.

IX.

Ky Akt themelimi u redaktua në 2 (dy) ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim dhe nen për nen dhe u nënshkrua nga ortakët në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

Ngarkohet administratori Besmir KOKOMIRI, ose personat e Autorizuar prej tij për të kryer të gjitha procedurat pranë QKB-së për regjistrimin e shoqërisë.

*Akti i Themelimit është hartuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008
"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.*



PËR ORTAKËT THEMELUES TË SHOQERISË

AES Group Sh.p.k.

Kledja Jaho
Signature



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Sh.p.k.
AES GROUP
NUI: L91910013 P
Tirana - Albania

Klea Sunpower Sh.p.k.

Elsa Hasantari
Signature

